

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE  
"REZERVA" sh.p.k**

Sot në datën 07.05.2020 shoqëria "Primis Real Estate" sh.p.k., me NUIS- L81721003K, me administrator z. Arkond Canaj dhe shoqëria "Feniks Konstruksion" sh.p.k., me NUIS- L47324203K me administrator z. Ilir Shyti dhe z. Jaho Shyti vendosen themelimin e shoqërisë "REZERVA" sh.p.k me terma si më poshtë

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare "REZERVA" sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

**NENI 2**

**Emri i shoqërisë**


Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin "REZERVA" sh.p.k

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria do të ketë si objekt:

1. "Administrimi, blerja, shitja, dhënia me qira e pasurive të paluajtshme, dhe të aseteve të tjera të ngjashme, vepra civile, tregtare, industriale qofte keto private ose publike; ndermjetesimi për shitje, blerje apo dhënie me qira të pasurive të paluajtshme dhe aseteve të tjera të vlerësueshme ekonomisht midis personave fizik, personave juridik private dhe publike. Konsulencë për projektimin, ndertimin, rikonstruksionin, permiresimin e pasurive të paluajtshme, konsulencë strategjike në investimet imobiliare si dhe studime e kërkime në sektorin imobiliar. Aktivitete të menaxhimit imobiliar nepermjet blerjes, projektimit, ndertimit të drejteperdrejte/jo të drejteperdrejte të ndertesave të destinuar për përdorim vetjak ose jo, për dhënie me qera ose për të shitur. Blerjen, ndertimin, shitjen dhe ndermjetesimin për të ndertesave të perfunduara dhe të paperfunduara për përdorim banueimi ose jo. Blerjen e trojeve për përdorim ndertimi ose jo. Veprimtari ekonomike në fushën e real estate, negocim, ndermjetesim dhe perfaqesim i të tremeve në transaksionet që lidhen me pasuritë e paluajtshme, si dhe çdo transaksion tjetër në funksion të 2 përbushjes së objektit të veprimtarisë në fushën e real estate dhe çdo veprim tjetër i ligjshëm që ka të bëjë me pasuritë e paluajtshme. Shërbime marketing, ekspertizë shitje, menaxhimi i pronës, ndermjetesim qiradhenie dhe shërbime të studimit të tregut të pasurive të paluajtshme. Konsulencë financiare, juridike dhe administrative në lidhje me tregun e pasurive të paluajtshme pa asnjë kufizim. Shoqëria mund të kryejë çdo



veprim apo operacion tjetër tregtar e financiar, të dobishëm apo plotësues të objektit të veprimtarisë së saj”.

2. “Tregti me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshme industriale e ushqimore . Komisioneri, ndërmjetësime, ndërmarrje hotelieri, turizëm, bar - restorant, si dhe hapje zyresh përfaqësimi brenda dhe jashtë vendit. Ndërtime civile-industriale-turistike-bujqësore. Ndërtime rrugësh, punime të mirëmbajtjes në rrugë, ndërtim mbi shtresa rrugore. Ndërtim ura dhe vepra arti. Ndërtim tunele rrugore - hekurudhore. Ndërtim ujsjelles- kanalizime, kanale e impiante vaditje-kullimi -Sillose, kulla, kulla uji etj prej B/arme- metalike. Të kryej vetëm apo me të treta konsulence ekonomike, kontrollore, analizuese, drejtuese, kërkuese ose që ka të bëjë me pasuritë e paluajtshme, industri dhe ekonomi. Prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike dhe termike nga burime energjitike konvencionale të një natyre të ngurte, të lenget apo të gazte me të gjitha teknologjitë e mundura. Prodhim dhe shitje të energjisë elektrike dhe termike nga burime energjitike të rinovueshme. Blerja dhe shitja e energjisë elektrike dhe termike autoprodhuar dhe / ose prodhuar nga të treta në Shqipëri dhe jashtë shtetit; dhe termike nga burime energjitike konvencionale dhe të 2 rinovueshme për llogari të vetes së tij apo të treta. Konsulence e finalizuar me themelimin e joint venture dhe raporteve të ortakorisë tregtare dhe prodhuese ndërmjet ndërmarrjeve të përfshira në të gjitha format e shkëmbimit tregtar. Aktivitet në promovimin dhe zhvillimin e pasurive të paluajtshme në sektorin turistik rezidencial. Agjent , operator tatarimor. Veprimtari në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe pëmtarisë. Përpunimi paraprak dhe përfundimtar i produkteve të ndryshme bujqësore, blegtoriale dhe frutore. Blerje shitje me shumicë a pakicë, i produkteve bujqësore, blegtoriale dhe frutore: Eksport, import i produkteve bujqësore, blegtoriale, frutore lendeve kimike e materialeve ndihmëse lidhur drejtpërdrejtë me veprimtarinë kryesore. Marrje me qera ambjentesh dhe tregjesh për të ushtruar këto lloj aktiviteti. Marrje pjesë në tendera dhe koncesione që kanë të bëjnë me veprimtarinë në fushën e tregtisë, pëmtarisë dhe prodhimin e frutave perimeve”.

3. “Agro - turizëm. Restorant. Grumbullim, përpunim qumështi, fruta-perime, mish. Bujtina. Investitor në ndërtim. Transport me mjetin e vet për nevojat e biznesit. Pike shitje për produkte dhe nënprodukte bujqësore, blegtoriale, artizanale, etj. Katering - Evente. Salle takimesh. Kantine vere – disteleri”.

#### **NENI 4**

#### **Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga “Murat Toptani”, Gjergji Center, Nr. 1 kati 6; Tiranë”.**

#### **NENI 5**

#### **Kapitali i Shoqërisë**



Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 100 000 (njëqind mijë lekë) ALL, i ndarë në 100 (njëqind) kuota.

Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë të ndara si më poshtë:

**Shoqëria "Primis Real Estate" sh.p.k., me NUIS- L81721003K, me administrator z. Arkond Canaj,** në cilësinë e ortakut që zotëron 67% të vlerës së kuotave e barabartë me 1 kuota me një vlerë të përgjithshme 67 000 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë lekë) ALL dhe **Shoqëria "Feniks Konstruksion" sh.p.k., me NUIS- L47324203K me administrator z. Ilir Shyti dhe z. Jaho Shyti**, në cilësinë e ortakut që zotëron 33% të vlerës së kuotave e barabartë me 1 kuota me një vlerë të përgjithshme 33 000 (tridhjetë e tre mijë lekë) ALL.

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët Themelues.

#### **NENI 6** **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pakufizuar. Afati i aktiviteti fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

#### **NENI 7** **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cilit zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i Shoqërisë është **Arkond Canaj**, i biri i Ifran- it, shtetas shqiptar, lindur në Vlorë, më 19.06.1989 dhe banues në adresën: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë. Person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i mjetit të identifikimit letërnjoftimit nr. BD4928997, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat ky fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara ç'do organi administrativ, gjyqësor, apo ç'do entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

#### **NENI 8** **Eksperti Kontabël**



Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

#### **NENI 9**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 10**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 11**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 12**

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

#### **NENI 14**

#### **Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi hartohet në 5 (pesë) kopje.

#### **ORTAKËT**

**Shoqëria "Primis Real Estate" sh.p.k**  
**Me administrator**  
**Arkond Canaj**



**Shoqëria "Feniks Konstruksion" sh.p.k.**  
**Me administrator**  
**Jaho Shyti (Përfaqësuar me**  
**prokurë nga Ilir Shyti)**

**Ilir Shyti**

